



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

### V E N D I M

**Nr. 45, Datë 30/5/2018**

#### PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINE RAJONALE TE MJEDISIT BERAT, "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË NË AKTIVITETIN E MONITORIMIT DHE MBROJTJEN E MJEDISIT ”.**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Qarku Berat, rezultoi që veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të lejeve për zhvillim aktivitetin mjedisor, zbatimin e kriterëve ligjore në administrimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor për aktivitete private gurore, ndërtim HEC-et , mungesën e transparencës së dëgjësive publike dhe përfshirjen në këto procedura të Njërive të vetqeverisjes vendore, pra nuk ka qenë plotësisht efektive, rrjedhojë e mungesës së bashkëpunimit dhe vlerësimit të përgjegjësive ligjore në mbrojtjen e mjedisit, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

#### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në aktivitetin e monitorimit dhe mbrojtjen e mjedisit”, të ushtruar në DRM Berat për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

#### **A. PROPOZIM PËR PËRMIRËSIM LIGJOR**

**1. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat në periudhën 2015-2017, sipas kërkesës dhe delegimit të AKM Tiranë për subjektet me aktivitet “Gurore” e “Përpunim Guri” ka dhënë 37 mendime për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe 38 mendime për Leje Mjedisore të Tipit B (Trajtuar më hollësisht në faqen 25-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe të dhënat sipas tabelës për dhënie mendimi për VNM e Leje B sipas tabelës të “Guroreve” bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit). Nga auditimi i këtij dokumentacioni rezultoi se:

Në 20 praktika të dhënies së mendimit për VNM për leje mjedisore të Tipit B për aktivitetin “Gurore”, ndarë: 8 praktika në vitin 2015, viti 2016, 6 praktika dhe 3 praktika për vitin 2017 si dhe në 11 praktika të vitit 2015 në dhënie të mendimit për leje mjedisore tip B nga auditimi u konstatuan mangësi e pamjaftueshmëri lidhur me mungesën e miratimit nga AKM Tiranë të formularëve standard, mungesë përfshirje e mos cilësim të dhënash në rubrikat përkatëse të formularëve të VNM-ve mitaruara nga AKM, lidhur me mospërcaktimet e statusit pronësor, shtrirjes territoriale dhe juridiksionit të aseteve, resurseve e pasurive (mosidentifikimin e tyre) sipas përkatësisë së NJVQV-ve. Kjo ka sjellë pasojë mos vendosjen e kushteve të rehabilitimit të sipërfaqeve të aseteve resurseve të tjetërsuara nga zhvillimi i VNM dhe lejes mjedisore, mos vendosjen nga AKM e kushteve lidhur me domosdoshmërinë e dokumentacionit që duhet mbajtur dhe mënyrën e hartimit të tyre gjatë verifikimit në terren si: akt-inspektimit, aktverifikimit, relacionit të specialisteve, mungesa e tërheqjes së mendimit të NJQV-së dhe njohjes së saj me procesverbalin të konsultimit me publikun.

Këto mangësi në vendimmarrjen dhe procedurat e dhënies së lejes B (nga bashkëpunimi AKM Tiranë dhe DRM Berat), kanë sjellë ngarkesa dhe shqetësime sociale në komunitetet përkatëse të NJVQV-ve dhe territoret ku ushtrohen këto aktivitete, duke krijuar ndotje të lartë mjedisore. Këto mangësi për periudhën e mëparshme dhe aktualisht, kanë ardhur nga faktin se nuk është vlerësuar Mendimi i NJVQV-ve me strukturat mjedisore të tyre edhe pse janë pronare dhe posedues juridiksional të territoreve. Gjendja e krijuar është në kundërshtim me nenet 26, 27 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.02.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Praktika e ndjekur nga AKM, Ministria përkatëse dhe DRM Berat, ka ardhur edhe për faktin e mangësisë e mospërmbushjes së kërkesave të shprehura në Kreun III, pika 4, kreu VI, pika 12 dhe pika 16 të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” (Trajtuar më hollësisht në faqen 70-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandim: AKM Tiranë dhe DRM Berat ne bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit,** të vlerësojë problematikat e hasura në auditimin e DRM Berat, e cila mbulon aktivitetin mjedisor të Qarkut të Beratit, mendojmë se lidhur me aktivitetet si: gurore, linja për prerje guri, pulari, përpunim lëkure etj, si dhe aktivitete të tjera lidhur me lejet e tipit A,B shtrirë në territoret me pronësi e juridiksion të NJQV-ve, të cilat kanë sjellë ngarkesa dhe shqetësime sociale në komunitetet përkatëse, ku ushtrohen këto aktivitete me ndotje të lartë mjedisore të merren masa për zgjidhje të qëndrueshme të këtyre problemeve, duke marrë iniciativë për ndryshime e përmirësim ligjor të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipeve A, B dhe C, si dhe për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja “konkretisht: Kreu III pika 2, ku të shtohet pas pikës c) një pikë ç), në të cilën të përfshihej marrja e mendimit edhe nga njësitë e NJQV-ve përkatëse dhe jo vetëm njoftim i tyre, pasi resurset e pasuritë e tjera, janë në juridiksion apo në pronësi të NJVQV-ve dhe pasojat mjedisore janë në këto zona. Këto masa bëhen edhe më të

domosdoshme aktualisht me kryerjen e reformës territoriale, mbështetur në rritjen e autonomisë dhe pavarësisë së NJVQV-ve përkatësisht në ligjet nr. 139/2015, datë 17.02.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe në akte të tjera nënligjore në zbatim të tyre; të cilat duhet të reflektohen e përfshihen edhe në aktet nënligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe dhënien e lejeve mjedisore.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat nuk ka bërë planifikimin vjetor të të ardhurave nga tarifat për aplikime të lejeve të tipit C, si dhe nga tarifat vjetore për leje mjedisi, mos veprim ky në mos përmbushje të kërkesave të nenit 23, pika ç të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 6-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarku Berat të marrë masat për çdo vit kalendarik të beje parashikimin e të ardhurave nga tarifat për aplikime të lejeve të tipit C, si dhe nga tarifat vjetore për leje mjedisi, në bazë të normave të programimit.

**Në vazhdimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarku Berat nuk ka ambiente pune të përshtatshme dhe të mjaftueshme për punonjësit, mungojnë orenditë, kompjutera, ka mungesë sipërfaqe për funksionimin e arkivit dhe protokollit, sipas ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe normave të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** DRM Berat t’i kërkojë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, mundësinë e zgjidhjes së gjetjes së ambienteve të përshtatshme të zyrave për të krijuar kushte pune për punonjësit e kësaj drejtorie, si dhe krijimin e zyrës së arkivit e protokollit.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në DRM Berat për periudhën 2015- 2017, nuk ka një databazë dhe një evidencë të grupuar të refuzimeve sipas problematikave (shkaqeve kushteve), aktiviteteve, zonave rajonale): Që nuk është kërkuar edhe nga AKM. Ekzistenca e databazë së refuzimeve do të nxiste rritjen e shkallës së menaxhimit të DRM Berat, sistemin e MKB, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** DRM Berat dhe AKM Tiranë, të marrin masa për vendosjen e një databazë dhe një evidencë të grupuar të refuzimeve sipas shkaqeve (kushteve), aktiviteteve dhe të grupuar në zonat rajonale; me synim rritjen e shkallës së menaxhimit të DRM Berat, funksionimin e sistemit të MKB, reduktimin dhe eliminimin e risqeve, nxitjen dhe mbështetjen e subjekteve në procesin e pajisjes me leje mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat në formulimin e akte refuzimet e lejeve të tipit C, nuk ka përcaktuar aktin nënligjor dhe pikën përkatëse të shtojcës për secilin prej kushteve të pa plotësuar, duke u mjaftuar vetëm me përmendjen apo citimin e ligjit, nr.10431 datë 09.06.2011”Për Lejet e Mjedisit ” si dhe nuk janë përdorur të njëjtat standarde në lidhje me kushtet që duhen të plotësojnë subjektet aplikuese për lejet e mjedisit tipi C. Kjo ka sjellë mos përdorimin e të njëjtave standarde në lidhje me kushtet që duhet të plotësojë subjekti. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 41-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1.Rekomandimi:** DRM Berat të marrë masa, që pas shqyrtimit të dosjeve për aplikim të lejeve, komisionet e shqyrtimit të lejeve të përgatisin dhe formulojnë akt-refuzimet në mënyrë të rregullt duke plotësuar me shkaqet e refuzimit bazën nën ligjore dhe kushtet sipas pikave të shtojcës përkatëse.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat nuk ka të evidentuar (nuk u paraqit gjatë procesit auditimit) listën e plotë të subjekteve mbajtëse të Lejeve Mjedisore të Tipit C, mungojnë akt rakordimet periodike me DR Tatim Taksave Berat, me QKL apo dhe me NJVQV-të (5 bashkitë) për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në Qarkun Berat e që kanë ndikim në mjedis dhe kanë detyrimin e pajisjes me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive mundësinë e shprehjes me një tregues të përgjithshëm të evazionit në lejet mjedisore, lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis për Zonat (zonat me ndikim të lartë mjedisor), në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, ligji nr. 1043, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar dhe paketës ligjore për mjedisin (*Trajtuar më hollësisht në faqet 46-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandimi:** DRM Berat dhe AKM Tiranë të marrin masa për të evidentuar e ndjekur subjektet mbajtës të Lejeve Mjedisore të Tipit C, duke rakorduar me DRTT Berat, me QKL me NJVQV-të për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në Qarkun e Beratit. Të hartojnë një listë të subjekteve që kanë detyrimin e pajisjes me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive, të dhëna këto që do të siguronin ndjekjen dhe analizën e problematikës së mbrojtjes së mjedisit, procesin e liçensimit të subjekteve me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) për Qarkun.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Është konstatuar se procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve teknike për verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për miratimin ose refuzimin e lejeve mjedisore, kanë mangësi në konceptim dhe formulim, nuk evidentojnë diskutimet, situatat, zhvillimin e tyre, si dhe nuk kanë prezantuar para Drejtorit të DRM Berat informacion të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishtme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”. Pavarësisht fluksit të vogël të aplikimeve për leje mjedisi, në mbledhjet e komisionit, konstatohet se dosjet nuk janë studiuar mirë nga specialistët, mungojnë analizat dhe diskutimet cilësore për vendimmarrje sa më të drejtë. Nuk është dhënë referencë dhe argumentim ligjor për arsyet e refuzimit të kërkesave për leje mjedisi të tipit C. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 20-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 Rekomandimi:** DRM Berat të marrë masa që të pasqyrohet në procesverbalet e mbajtura të mbledhjes së komisioneve informacioni i plotë për vlerësimin e dokumentacionit, për leje mjedisi tipi C, duke argumentuar aktet e miratimit apo refuzimit arsyet me argumentet përkatëse. Për këtë në aktmiratime të përcaktohen zotërimi i dokumenteve të pronësisë, dokumentit të mendimit të NJQ-ves dhe informacion tjetër që lidhet me mbrojtjen e mjedisit

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**6.2 Rekomandimi:** DRM Berat të marrë masa që në përfundim të shqyrtimit të dosjeve për aplikim të lejeve, komisionet e shqyrtimit të lejeve të përgatisin akt-refuzimet të cilat duhet të përmbajnë studimin e plotë të dosjes së aplikimit. Të citohen saktësisht dhe në mënyrë objektive

arsyet e refuzimit, të argumentohet profesionalisht mangësitë ligjore dhe dispozitat përkatëse, duke kërkuar respektimin e kushteve apo kriterëve ligjore që duhen plotësuar nga subjektet.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**7. Gjetje nga auditimi.** Në periudhën 2015-2017 janë lincësuar 33 pika karburanti dhe furnizim për mbushje gazi NT, të cilat u verifikua Kushti 5-Shkarkime në Ajër, ku rezultoi se formulimi i tij ka mangësi (i paplotë dhe përshkruhet “Shkarkimet në ajër në këtë aktivitet nuk ka), nuk është shoqëruar me tabelën me normat e shkarkimeve, pra kryerja në këtë mënyrë e një procesi formal këto veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448, datë 14.07.2011, Shtojca 2 “Për vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve”, “Lista indikative e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve”, si pjesë e kushteve për dhënien e lejes së mjedisit Tipi “C”, e përcaktuar si kërkesë bazuar në VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10, dhe në VKM nr. 435, datë 12.9.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”. Akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit “C” për çdo instalim, përmban sipas rastit, vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi. Vlerat kufi të shkarkimeve sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo për ndotës të veçantë”, pasqyruar në tabelën emërtuar “Licencimi i pikave të karburantit me kushtin 5 – Shkarkimet në ajër, për periudhën 2016-2017”(Trajtuar më hollësisht në faqet 29-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** DRM Berat Drejtori dhe komisionet të marrin masa për të hartuar në mënyrë të saktë formulimin hollësisht dhe të detajuar proces-verbalet dhe aktet e miratimit të kërkesave për leje mjedisi Tipi “C”, mbi bazën e respektimit të vlerave kufij të shkarkimeve për komponentët mjedisorë “Ajri” dhe “Uji”, duke ruajtur respektimin e vlerave kufi për agjentë atmosferikë të komponentëve mjedisorë.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në DRM Berat u konstatua se subjektet që paraqesin raportet e vetëmonitorimit nuk kanë saktësinë dhe besueshmërinë e analizave, pasi mungojnë laboratorët shtetëror me ndihmën e të cilëve mund të sigurohet informacion mbi saktësinë e laboratorëve të akredituar sipas VKM nr. 1185 dt 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit në mjedis”, vendim i cili ka nevojë për ndryshime dhe përshtatje me kushtet e reja, që kanë sjellë mangësi në raportet e vetëmonitorimit (Trajtuar më hollësisht në faqet 88-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** DRM Berat dhe AKM të marrin masa që të parashikojnë fondet të nevojshme për pajisje laboratorike, ose të lidhin kontrata me subjekte të licencuara dhe akredituara për marrjen e shërbimit të kërkuar për plotësimin e VNM me analiza shoqëruese.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat gjatë vitit 2015, në miratimin e lejeve mjedisore të tipit C (LC) për 4 subjekte me aktivitet “Tregtim karburanti-gaz plus Lavazh” nuk ka përfshirë kushtin e monitorimit dhe vetëraportimit lidhur me shkarkimin e ujërave të përdorura për pjesën e aktivitetit të lavazhit në pikën 5.4 “Ujërat nëntokësore dhe toka”, përkatësisht për licencat nr. 50,52,57,58, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari akt-miratimit pika 10, germa a, b, c VKM nr. 419, datë 25.6.2014” “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi të Tipeve A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL”, pasqyruar në tabelën “Tabela e miratimeve të lejeve tipi C, afatet e trajtimit, aktkontrollet për DRM Berat viti 2015”(Trajtuar më hollësisht në faqet 20-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandim:** DRM Berat të marrë masa të rishqyrtojë lejet tipit C (LC ) të lëshuara viti 2015 për 4 subjekte me aktivitet “Tregtim Karburanti-Gazi plus Lavazh“ dhe të përfshijë kushtin e monitorimit dhe vetë raportimit lidhur me shkarkimin e ujërave të përdorura që i përket pjesës së aktivitetit të lavazhit në pikën 5.4 “Ujërat nëntokësore dhe toka”, përkatësisht: Akti miratimit LC-4050-07-2015, datë 24.07.2015, (nr.57 i tabelës) Akti miratimit LC- 4029-07-2015, datë 14.07.2015(nr. 52 i tabelës), Akti miratimit LC- 4050-07-2015, datë 24.07.2015, (nr. 57 i tabelës) dhe Akti miratimit LC- 4028-07-2015, datë 24.07.2015(nr.58 i tabelës). Të kërkojë plotësimin e kushteve të munguara dhe të verifikojë plotësimin e kushteve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet, si ujërat, kimikatet, vajrat e përdorura, mbetjet e ngurta apo të lëngëta etj, si dhe në mosplotësim të kushteve të anulujë lejet e lëshuara dhe të njoftojë DRISHMP Berat.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat për periudhën 2015-2017 në miratimin e lejeve mjedisore të tipit C (LC) për 15 subjektet me aktivitet “Larje dhe pastrim mjjetesh motorike” (Lavazhe makinash) nuk ka përfshirë kushtin e monitorimit dhe vetë raportimit lidhur me shkarkimin e ujërave të përdorura në pikën 5.4. 2 “Ujërat nëntokësore dhe toka”, përkatësisht për licencat nr. 14, 21, 39, në kundërshtim me shtojcën 6, PIKA 9, Kreu IV formulari akt-miratimit pika 10, germa a, b, c VKM nr. 419, datë 25.6.2014, pasqyruar në tabelën:“Tabela e Miratimeve të lejeve tip C afatet e trajtimit, aktkontrollet për DRM Berat për periudhën 2015-2017” (Trajtuar më hollësisht në faqet 20-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandim:** DRM Berat të marrë masa dhe të rishqyrtojë lejet tipit C (LC) të lëshuara në periudhën 2015-2017 për 15 subjektet me aktivitet “Larje dhe pastrim mjjetesh motorike” dhe të përfshijë kushtin e monitorimit dhe vetë raportimit lidhur me shkarkimin e ujërave të përdorura në pikën 5.4. “Ujërat nëntokësore dhe toka”, si dhe të kërkojë plotësimin e kushteve të munguara dhe të verifikojë plotësimin e kushteve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet, si ujërat, kimikatet, vajrat e përdorura, mbetjet e ngurta apo të lëngëta etj, si dhe në mosplotësim të kushteve të anulujë lejet e lëshuara dhe të njoftojë DRISHMP Berat.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat për periudhën 2015-2017 në miratimin e lejeve mjedisore të tipit C (LC) për 22 subjekte me aktivitet “Prerje, gdhendje dhe lustrim guri”, nuk ka përfshirë dhe nuk është përcaktuar qartë kushti vendi i depozitimit të mbeturinave (të cilat depozitohen anës rrugëve), pasi në kushtin 3.1 nuk përcaktohet vendi i depozitimit, ose mungojnë mendimet e Bashkive dhe bashke me të dhe përcaktimi i vendit, i Hartës depozitimit të mbeturinave ose nuk është marrë në konsideratë mendimi refuzues i Bashkisë. Mangësi këto që nuk janë marrë në konsideratë nga DRM Berat në dhënien e lejeve përkatëse në kundërshtim me shtojcën 6, PIKA 9, Kreu IV formulari akt-miratimit pika 10, germa a, b, c VKM nr. 419, datë 25.6.2014, pasqyruar në tabelën “Tabela e Miratimeve të lejeve tip C afatet e trajtimit, aktkontrollet për DRM Berat për periudhën 2015-2017” (Trajtuar më hollësisht në faqet 20-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandim:** DRM Berat të marrë masa dhe të rishqyrtojë lejet tipit C (LC) të lëshuara për periudhën 2015-2017 për 22 subjekte me aktivitet “Prerje, gdhendje dhe lustrim guri”, ku të përfshijë kushtin 3.1 vendi i depozitimit të mbeturinave sipas Hartës përcaktuar nga Bashkitë si dhe tu kërkojë Bashkive plotësimin e tyre në dhënien e mendimeve, vend-depozitimet dhe hartat përkatëse për këto aktivitete.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat për periudhën 2015-2017 në 27 raste nuk ka zbatuar kërkesat e kreut të IV-të VKM nr.419, datë 25.06.2014 pika 2 dhe 3, ku citohet se brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit, DRM dërgon një kopje të aplikimit në NJVQV, e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda 3 (tre) ditëve pune (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandimi** DRM Berat të marrë masa për dërgimin e kopjeve të aplikimit të subjekteve në NJVQV-në përkatëse dhe të respektoj afatin e pritjes së përgjigjes nga NJVQV, e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda tre ditëve. Në mungesë të dhënies së mendimit nga NJVQV brenda afatit 3 ditor, DRM Berat të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për pajisjen e subjektit me leje mjedisi tipi C sipas dispozitave ligjore.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**13. Gjetje nga auditimi.** DRM Berat në Raportin e gjendjes së mjedisit të hartuar për periudhën 2015-2017, ka trajtuar Qarkun e Beratit me vlera për aktivitetin e shfrytëzimit dhe përpunimit të gurit, ku ushtrojnë aktivitetet **80 subjekte** me aktivitet nxjerrjen dhe përpunimin e gurit të pajisura me leje shfrytëzimi minerar e mjedisor. Në raport nuk është trajtuar problemi i rehabilitimit, nuk ka filluar të bëhet rehabilitimi i zonës ku kryhet aktiviteti (që nga vitet 2006 deri në 2016 që disa prej tyre kanë bërë riformatim të lejes dhe nuk kanë asnjë kusht apo kriter detyrues për të filluar me rehabilitimin, megjithëse në disa zona të këtij Qarku vërehet se për disa vjet janë shfrytëzuar inertet malore dhe lumore, por nuk janë rehabilituar. Gjithashtu, nuk janë zbatuar kushtet e lejes minerare e mjedisore, si dhe nuk është punuar sipas kushteve teknike. Shfrytëzimi është i pa kontrolluar dhe nuk punohet shkallë-shkallë nga lart poshtë si mundësi e lehtë dhe teknike për rehabilitim (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1.Rekomandimi:** DRM Berat në bashkëpunim me AKM Tiranë dhe DR ISHMU Berat të marrë masa për krijimin e një databaze mbi aktivitetin e shfrytëzimit dhe përpunimit të gurit dhe të shikohet me përparësi problemi i rehabilitimit, duke filluar të bëhet rehabilitimi i zonës ku kryhet aktiviteti (që nga vitet 2006 e deri në 2016) që nuk janë rehabilituar për mbrojtjen e shtresës vegetative të tokës dhe mbrojtjen e aftësisë për të prodhuar.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat për periudhën 2015-2017 nuk ka patur një program tërësor pune për bashkëpunimin dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta, megjithëse ka patur 3 bashkëpunime si; për mbetjet urbane, për kushtet e lejeve të guroreve dhe fabrikave të lëkurave si dhe me 5 Bashkitë për mbetjet spitalore, por bashkëpunimi nuk është shtrirë me institucione si me DRTT Berat dhe ISHMPU për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe kërkesave të përcaktuara në Kreu 5, germa pika 1/n, kreu 6, germa a e VKM nr. 47, datë 29.1.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit”(Trajtuar më hollësisht në faqet 96-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1.Rekomandimi:** DRM Berat të marrë masa për hartimin e programit vjetor tërësor, planet e punës dhe programe kontrolli bashkëpunimi për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta me organet e tjera të kontrollit në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet AKM Tiranë dhe DRM Berat me organet e tjera të kontrollit, si me Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave dhe DR ISHMU për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**15. Gjetje nga Auditimi:** Drejtoria Rajonale e Mjedisit Berat për periudhën 2015-2017 ka dhënë 207 mendime për Vlerësime të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe për leje mjedisore për licencimet

të Tipit A, B nga AKM. Për këto, DRM Berat nuk ka informacione nga AKM Tiranë për ecurinë e procedurës për 127 praktika të dhënies të mendimit, nga të cilat 79 për VNM dhe 48 për Leje Mjedisore, ka sjellë si pasojë mosndjekjen e afateve dhe procedurave ligjore. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 1964, datë 13.11.2014 “Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit A, B dhe C. “Të dhënat sipas tabelës 7 të krahasimit të Regjistrat të mendimeve për VNM dhe Lejeve Mjedisore tipi A-B për periudhën 2015-2017 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit ” (Trajtuar më hollësisht në faqet 56 -60 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

**15.1.Rekomandim:** DRM Berat të kryejë korrespondencë zyrtare me AKM Tiranë për marrjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e praktikave të dhënies së mendimeve për VNM e Leje mjedisore A-B me synim përditësimin në formë elektronike të regjistrat të lejeve të tipit A,B sipas formatit standard të miratuar, zbatimin e afateve dhe procedurave ligjore si dhe mundësimin e bashkëpunimit ligjor me strukturat e tjera si DRISHMU, NJVQV-të dhe QKL.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**16. Gjetje nga Auditimi:** DRM Berat në dokumentacionin e dosjeve për dhënien e mendimeve për VNM e Leje Mjedisore në 92 raste, nga të cilat 45 për VNM dhe 47 për Leje Mjedisore të tipit B, *mungonin dhe nuk u gjetën procesverbalet e konsultimeve me publikun*, megjithëse në shkresat e mendimeve shpreheshin se, “u krye procesi i dëgjësës me publikun”, si dhe nuk ishin dërguar NJVQV-e përkatëse, ku ushtrojnë aktivitetin subjektet aplikuese për Leje të tipit B. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore të Tipave A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL” Kreu I, pika 1/dh, Kreu VI, pika 12,13,15,16.

Ndërsa në 17 praktika të dhënies së mendimeve për VNM, rezulton se cilësia e kryerjes së inspektimit në terren është e pa plotë, kjo nisur nga formulimet në pikën 6 të mendimeve të dhëna me titull “Mendimi i DRM pas inspektimit në terren”, pasi shprehet në këto formë: “... ARM Berat gjatë procesit të konsultimit me publikun mori informacion të saktë të llojit të aktivitetit dhe të efekteve që do sjellë në mjedis. Më tej ARM Berat shprehet se ka firmosur procesin e konsultimit me publikun “vetëm për praninë tonë”, duke konfirmuar në dhënien e mendimit edhe miratimin për ushtrimin e aktivitetit të subjektit”. Kjo shprehje, nuk vërteton marrjen e mendimit të publikut (NJVQV-së ose kryeplakut, etj.), kjo tregon se ky konsultim është formal dhe i pavërtetuar me dokument, si dhe jo funksional.

Në 5 raste të dhënies të mendimeve për VNM dhe Leje Mjedisore, ku në konsultimet me publikun janë shprehur ankesa e mendimeve negative nga komuniteti dhe NJVQV-të, ka transmetuar thjesht ankesat dhe ka dhënë sugjerime shtesë pa dhënë mendim të prerë për vazhdim procedure apo refuzim, ose është shprehur për vazhdim procedure pa dhënë argumentet përkatëse. Për më tepër, kur AKM nuk ka informacion për DRM për veprimet e kryera kundrejt kundërshtimeve të publikut, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisore të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL”, Kreu VI, pika 15,16. Të dhënat sipas tabelës 7 të krahasimit të Regjistrat të mendimeve për VNM dhe Lejeve Mjedisore tipi A-B për periudhën 2015-2017 bashkëlidhur këtij Raportit të Përfundimtar të Auditimit (Trajtuar më hollësisht në faqet 56-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**16.1. Rekomandim:** DRM Berat dhe AKM Tiranë të marrin masa që të plotësojnë praktikën e dhënies së mendimeve për 92 raste për periudhën 2015-2017, si dhe tu dërgohen NJVQV-ve përkatëse, duke përditësuar regjistrin e të dhënave për VNM- ve të Leje mjedisore. Gjithashtu DRM Berat dhe AKM të bashkëpunojnë dhe të marrin masa për rregullimin e normimit juridik të pikës 6 “Mendimi i DRM pas inspektimit në terren”, të formatit dhënie mendim për VNM dhe LM, me synim bërjen e tij funksional dhe sigurimin e vërtetësisë për përfshirjen e mendimit të NJVQV në VNM dhe ne lejet e tipit A.; si dhe të merren masa që në të ardhmen në çdo rast, veçanërisht ku publiku shpreh ankesa e mendime negative, gjatë procesit të tërheqjes së mendimit për VNM dhe Leje Mjedisore të pasqyrojnë qartë dhe të argumentojnë dhënien e mendimit, duke i bashkëlidhur procedurës dokumentet përkatës.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Ministra e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM Tiranë për periudhën 2015-2017 në 55 raste të procedurave të liçencimit kundrejt totalit 190 mendime për VNM dhe 36 mendime për Leje Mjedisore të Tipit A dhe B, nuk janë respektuar afatet nga momenti i marrjes së mendimit deri në momentin e miratimit të lejes prej 25 ditësh të miratuar, apo në 4 raste subjektsh me aktivitet “gurore” e “prodhim blloqe”, mungon mendimi për VNM nga DRM Berat për Leje Mjedisore të miratuara nga AKM (procedurat nr. 2,4,5,6) dhe në 3 raste (procedurat me nr. 54,55,59) për subjektin:“XXXX B”, i cili ka aplikuar për 3 herë për aktivitetin me objekt “kërkim i naftës dhe gazit natyror” **janë dhënë mendime për VNM në mënyrë formale pas miratimit të lejeve**. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore të Tipave A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL” Kreu II, pikat 2,4,5,6,12 dhe Kreu III, pikat 2,4,5,6,10. Të dhënat sipas tabelës 7 të krahasimit të Regjistrit të mendimeve për VNM dhe Lejeve Mjedisore tipi A-B për periudhën 2015-2017 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit (*Trajtuar më hollësisht në faqen 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1 Rekomandim:** DRM Berat, AKM dhe Ministria e Mjedisit të marrin masa që në procedurat e liçencimit në fazat e dhënies së mendimeve për VNM dhe të mendimeve për leje të tipit B të respektohen afatet ligjore, me synim shpejtimin dhe nxitjen e investimeve të investitorëve të brendshëm dhe të huaj. Gjithashtu të eliminohen rastet e miratimit të lejeve mjedisore pa marrjen e mendimit nga DRM Berat, si dhe rastet e dhënies ose tërheqjes së mendimeve për VNM e leje të Tipit A-B pas miratimit të lejeve nga strukturat e prore.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat dhe AKM Tiranë në të gjitha praktikën e dhënies së mendimit për VNM dhe për Leje Tip A e B, janë mbështetur në formate standarde dhënie mendimi për VNM dhe mendimi për Lejes Mjedisore A/B të përcaktuar në një kërkesë nr. 228, datë 3.2.2016 të Drejtorisë së Vlerësimit Mjedisor, drejtuar z. J. B. , Drejtor i AKM, e cila është e pa miratuar nga Ministri. Këto formate kanë mangësi në formë, përmbajtje dhe funksion, pasi në pjesën fillestare të saj nuk janë përfshirë elementët si:” ...bazuar në kërkesën nr, datë, apo email-e datë, apo në autorizimin e AKM “, ekzistenca e të cilave do bënte të mundur evidentimin dhe zbatimin e afateve të procedurës së dhënies mendimit VNM dhe mendimit për leje mjedisore tip A, B. Gjithashtu në këto formate mungojnë treguesit identifikues të pasurisë, juridiksioni i shtrirjes dhe veçanërisht ftesa për detyrimin e pjesëmarrjes së NJVQV-ve përkatëse, veprime në mospërputhje me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore të Tipave A,B dhe C, për transferimin e

lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL” shtojcën 4 dhe 5.

-Për periudhën 2015-2017 në praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente plotësuese dhe mbështetëse, që dëshmojnë realizimin e procedurave si: akti i inspektimit apo aktivverifikimit në terren si dhe relacioni i përshkrimit të procedurës me emrat e specialisteve që kanë kryer atë, dokumente këto paraprahe mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi e firmosur nga Drejtori i DRM Berat.

-Në periudhën 2015-2017 të shumtën e rasteve në dhëniet e Mendimeve për VNM dhe mendimeve për Leje Mjedisore nga DRM Berat mbi të cilat behet licencimi nga AKM të subjekteve të paraqitura në tabelën bashkëlidhur akt-konstatimit *mungon mendimi dhe ftesa për konsultim e organeve të pushtetit vendor (NJVQV)*. Edhe në rastet kur është mbajtur procesverbali i dëgjësës, nuk është dokumentuar mbajtja në prani të përfaqësuesve të NJVQV, si dhe nuk kanë konfirmim të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me vendimin 419 datë 25.06.2014, Kreu VI, pika 12, ku shprehet se: “Procesverbali i dëgjësës mbahet nga kërkuuesi dhe nënshkruhet nga pjesëmarrësit në dëgjësë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut ,palëve pjesëmarrëse në dëgjësë,NJVQV-së dhe AKM-së”,si dhe me VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore (Trajtuar më hollësisht në faqet 60-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

**18.1.Rekomandim:** DRM Berat dhe AKM Tiranë të marrin masa dhe të hartojnë dhe miratojnë formate standard për dhënie mendimi për VNM dhe mendimi për Leje Mjedisore A/B, duke përfshirë në formatin tip përshkrimet: kërkesën nr, datë, apo email-e, datë, ose shprehjen: “bazuar në autorizimin e AKM”,treguesit identifikues të pasurisë a resursit, juridiksionin e shtrirjes dhe veçanërisht ftesën për realizimin e detyrimit ligjor të pjesëmarrjes së NJVQV-së që ushtron juridiksionin territorial. Gjithashtu të përcaktojnë formatin tip të aktit të inspektimit në terren, të relacionit përkatës të specialistëve, si dhe dokumentimin e formatin e konsultimit me publikun dhe NJVQV-ët.

**18.2.Rekomandim:** DRM Berat dhe AKM të marrin masa, të përcaktojnë në një udhëzim të posaçëm me kritere caktuara, për rastet e verifikimit dhe përpunimit të praktikave për dhënie mendimi për VNM apo Mendimi për Leje mjedisore Tipi A-B. Në lidhje me zbatimin e kërkesave për VNM apo Mendimi për Leje mjedisore Tipi A-B të veprohet në mënyrë të njëjtësuar si në shqyrtimet e procedurave të dhënieve të mendimeve dhe miratimet për lejet e Tipi C ,si dhe të përcaktojnë e miratojnë me udhëzim formatet përkatëse të dokumenteve mbështetëse e përfshijnë ato në dosje me synim vërtetimin e realizimit të procedurave dhe justifikimin me dokumente në dhënien e mendimit për VNM dhe Leje A,B.

**18.3. Rekomandim:** DRM Berat dhe AKM Tiranë të marrin masa për tërheqjen e mendimit dhe të ftojnë për konsultim NJVQV-të, në procesin e dëgjësave për dhënien e Mendimeve për VNM e për Leje Mjedisore përgatitur nga DRM Berat mbi të cilat bëhet licencimi nga AKM të subjekteve aplikues për tërheqjen e mendimit dhe të ftojnë për konsultim NJVQV. Kjo të dokumentohet në procesverbalin e dëgjësës të mbajtur në prani të përfaqësuesve të NJVQV-ve, duke konfirmuar praninë e tyre,si dhe këto dokumente të jenë pjesë e dosjes

## **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat për 12 subjekte me aktivitetet “Instalimin për prodhimin e energjisë hidroelektrike të HEC” prej të cilave 3 raste në vitin 2015, 3 raste në vitin 2016 dhe 6 raste në vitin 2017 ka dhënë mendime për VNM, duke mos llogaritur,mbajtur e vlerësuar faktorin e prishjes së regjimit natyral të rrjedhjes ujore përgjatë vitit të lumit Osum, si burim i

rëndësishëm ujon, ku regjimi i hidrocentralit ndikon mbi florën dhe faunën në rrjedhën e përrrenjve, me pasojë gjithashtu edhe në vënien e mbajtjen në funksion të Kanioneve të Osunit, si atraksion kryesor për resursin turistik për zonën e Skraparit sipas tabela 7/1 e dhënies mendimeve nga DRM Berat per VNM dhe lejeve mjedisore tipi A-B, për HEC-et dhe për guroret për çdo vit 2015,2016 dhe 2017(*Trajtuar më hollësisht në faqen 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe të dhënat sipas tabelës*).

**19.1. Rekomandim:** DRM Berat në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM Tiranë, *të marrin masa për rishqyrtimin e verifikimin e dhënies së VNM-ve për 12 HEC-e në Qarkun Berat, duke përfshirë në VNM dhe vlerësuar e konsideruar faktorin e prishjes a ndryshimit të regjimit natyral të rrjedhjes së ujërave që do përdoren si burim energjie, në funksion të florës, faunës, vënies e mbajtjes funksionale të Kanioneve të Osunit si atraksion kryesor e resurs turistik unikal për Shqipërinë dhe në Europë.*

Rishqyrtimi të bëhet përkatësisht për: 3 VNM dhënë në vitin 2015 për HEC 3 (HEC) Vendresh, HEC 6. Bigas 1&2, HEC Veleshnje nr.12; për 3 VNM në vitin 2016 përkatësisht HEC Hp Prishta 1 & 2 Energy/Selia Cepan Skrapar, HEC HP Z ENERGY,HEC LF Kreshov (procedurat nr. 27; 38; 60 ) si dhe për 6 VNM në v. 2017 përkatësisht: HEC Kreshova/Corovode Malind 1,2,3 Skrapar, HEC D. shpk., HEC DAAP energy ,GROUP Dobrenje Tomorrice, HEC Hec-Mivas 1, Subjekti T E Zhep Skrapar,HEC-ve Vokopola përroi i Komarit Tepelene-Skrapar, HEC N. E. Bogovë Skrapar (me procedurat nr. 8,24,29,30,56,63), pasqyruar në tabelën emërtuar: “ 7/1 Tabela e dhënies mendimeve nga DRM Berat për VNM dhe lejeve mjedisore tipi A-B, për HEC-et dhe për guroret për çdo vit 2015,2016 dhe 2017.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat për periudhën 2015-2017, sipas kërkesës së AKM për subjektet me aktivitet “Gurore” e “Përpunim Guri” ka dhënë *37 mendime* për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe *38 mendime* për Leje Mjedisore të Tipit B, ndarë sipas viteve: për vitin 2015 janë dhënë 19 për VNM dhe 11 Leje tip B, për vitin 2016 janë dhënë 13 për VNM dhe 16 për Leje B, për vitin 2017 janë dhënë 5 për VNM dhe 11 për Leje B. *Trajtuar më hollësisht në faqen 25-96. të raportit të Auditimit dhe të dhënat sipas tabelës për dhënie mendimi për VNM e Leje B sipas tabelës të “Guroreve” bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*). Nga auditimi i këtij dokumentacioni rezultoi se:

Në 20 praktika të dhënies së mendimit për VNM dhe për leje mjedisore të Tipit B për aktivitetin “**Gurore**”, ku 8 praktika për vitin 2015, 6 praktika për vitin 2016 dhe 3 praktika për vitin 2017 në dhëniet e mendimeve për VNM, pasuar dhe në 11 praktika të dhënies së mendimit për leje mjedisore tip B në vitin 2015 paraqiten mangësi në lidhje: me mungesën e miratimit të formularëve standard, me mos përfshirjen e mos cilësimin në rubrikat përkatëse të përcaktimeve të statusit të pronësor e të juridiksionit të NJVQV-ve përkatëse, me mos vendosjen e kushteve të rehabilitimit, mos vendosjen e kushteve lidhur me domosdoshmërinë e dokumentacionit që duhet mbajtur dhe mënyrën e hartimit të tyre gjatë verifikimit në terren si: akt-inspektimit, aktverifikimit, relacionit të specialisteve, mendimit të NJQV-së dhe procesverbalit të konsultimit me publikun. Këto mangësi në vendimmarrjen e dhënies së lejes B, janë në kundërshtim me Kreu III, pika 4, kreu VI, pika 12 dhe pika 16 të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 70-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1. Rekomandim:** DRM Berat në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM Tiranë, të marrin masa për ndjekjen e procesit të lidhur me plotësimin e dosjeve me

dokumentacionin e munguar për dhënie “mendimi për VNM” dhe për dhënie “mendimit për leje Tipi B”, të përgatitura nga DRM Berat, për rastet e mëposhtme:

1. Me Vendim të Komisionit nr.3 viti 2015 subjekti “XXXX-08” (procedura nr.2 sipas tabelës) me vendndodhje Novaj, komuna Bogovë, Qarku Berat, për ushtrim aktiviteti “Gurore”.
2. Me Vendim të Komisionit nr.36 viti 2015 subjekti “YYYY” (procedura nr.16 sipas tabelës) me vendndodhje Roshnik Berat, për ushtrim aktiviteti “Gurore”.
3. Me vendim Komisionit nr. 28, datë 21.08.2015 subjektin “ZZZZZZ” (procedura nr.32 sipas tabelës), me vendndodhje në ish-komunën Gjrbës Skrapar zona minerare (1366), objekti Melovë për ushtrim të aktiviteti “Gurore Mermeri”.
4. Me Vendim Komisionit nr. 35 , datë 28.10.2015 pa VNM të DRM Berat, subjekti “T EF”(procedura nr. 37/10 sipas tabelës), me vendndodhje në ish-komunën Leshnje-Melovë për ushtrim të aktiviteti “Gurore Mermeri” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 75-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

### **C. TË ARDHURA TË MUNGUARA**

**1. Gjetje nga auditimi:** DRM Berat për 61 subjekte të cilat nuk kanë sjellë vetëmonitorimin, në kundërshtim me nenin 29 pika b (ii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit ” për mosplotësimin e kushteve të lejes dhe plotësimin e numrit të vetëmonitorimeve do të mund të aplikoheshin gjopa nga 300 mijë lekë deri 500mijë lekë, për këtë rast të paktën kufiri minimal për vënie gjobe prej 300 mijë lekë, duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën **18,300 mijë lekë** ( $300 \times 61 = 18,300$  mijë lekë) si dhe për 34 subjekte të pa pajisura me leje mjedisore, në vlerën **10,200 mijë lekë** ( $34 \times 300 = 10,200$  mijë lekë ), pra në total vlera prej **28,500 mijë lekë, konsiderohet si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 25-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandim:** DRM Berat në bashkëpunim me DRISHMPU Berat, të marrë masa për fillimin e procedurave ligjore e administrative për llogaritjen dhe arkëtimin e vlerës prej **28,500 lekë nga subjektet të cilët nuk kanë sjellë vetëmonitorimin**, në kundërshtim me nenin 29 pika b (ii) i Ligjit nr. 10488, datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit ”, si dhe të pajisura me leje mjedisore.

**Brenda muajit Shtator 2018**

### **D. MASA DISIPLINORE**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë **Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kombëtare e Mjedisit**, për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga puna”, për 6 punonjësit e mëposhtëm:

1. z. **P. T.** me detyrë Drejtor i DRM-së Berat (për periudhën 21.02.2014 e në vazhdim)
2. z. **Xh. L.**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)
3. z. **E. K.** me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)

4. z. **A. P.**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)

5. z. **A. M.**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)

Për mangësitë dhe shkeljet konstatuar në përgatitjen e dokumentacionit të akt-miratimeve dhe akt-refuzimeve të lejeve të tipit C, mangësitë dhe shkeljet në dokumentacionin e dhënies së mendimeve për VNM dhe dhënies së mendimeve për Leje Mjedisore të tipit A e B në kundërshtim me Ligjin nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit” dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”

6. zj. **J. L.**, me detyrë Specialiste monitorimi për mangësitë e lidhur me mosplotësimin e numrit të raporteve të vetmonitorimit nga subjektet përkatëse të licencuara në kundërshtim me Ligjin nr. 10488, datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit” dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”

### **E. INDICIE PËR KALLËZIM PENAL:**

Bazuar në nenin 281, të Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, e ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, **për shkeljet e konstatuara dhe pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Adutimit**, në kuptim të referencave të Kodit Penal të dërgohet për indicie i gjithë materiali i përgatitur, për këta persona përgjegjës:

1. z. **P.T.**, me detyrë Drejtor i DRM-së Berat (për periudhën 21.02.2014 e në vazhdim) ne cilin miratuesit të akteve të miratimit apo refuzimit të lejeve mjedisore të tipit C si dhe të dhënien e mendimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe dhënies së mendimit për lejet e tipit A, B.

Specialistet e DRM Berat në cilësinë e anëtarëve të komisionit teknik për verifikimin dhe shqyrtimi të dokumentacionit në baze të kërkesave për pajisjen me leje mjedisi të tipi C si dhe të aplikuesve për miratimin ose refuzimin e lejeve mjedisore të tipit C si dhe për dhënien e mendimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe dhënies së mendimit për lejet e mjedisit të tipit A, B, të thelluar apo paraprake sipas Aplikimit, të paraqitur me poshtë :

2. z. **Xh.L.**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)

3. z. **E. K.**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)

4. z. **A. P.**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)

5. z. **E. K.**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)

6. z. **A. M.**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis (VNM)

Për shkeljet e mëposhtme:

DRM Berat për **12 Subjekte me aktivitetet “Instalimin për prodhimin e energjisë hidroelektrike të HEC” prej të cilave 3 raste në vitin 2015, 3 raste në vitin 2016 dhe 6 raste në vitin 2017 ka dhënë mendime për VNM për licencimin e tyre mjedisor, ku në të gjitha rastet:**

- Mungon mendimi dhe ftesa për konsultim e Organeve te Pushtetit Vendor (NJVQV); Edhe në rastet kur është mbajtur procesverbali i dëgjësës, nuk është mbajtur në prani të përfaqësuesve të NJVQV-ës si dhe nuk ka konfirmim të tyre. Praktikrat e dhënies së VNM në shkresën për VNM të tipit B në pikën 6 “pas inspektimit në terren” shprehet në mënyrë të pasaktë: “... *ARM Berat gjatë procesit të konsultimit me publikun mori informacion të saktë të llojit të aktivitetit dhe të efekteve që do sjellë në mjedis. Më tej ARM Berat shprehet se ka firmosur procesin e konsultimit me publikun “vetëm për praninë tonë”, duke konfirmuar edhe miratimin për ushtrimin e aktivitetit të subjektit*”. Kjo shprehje nuk vërteton marrjen e mendimit të publikut (apo NJVQV –se kryeplakut, etj), çka tregon se ky konsultim është formal i pavërtetuar me dokument si dhe jo funksional, rregullimi i se cilës kërkon ndryshim ligjor për përfshirjen e mendimit të NJVQV, në VNM dhe ne lejet e tipit A. Këto veprime janë në kundërshtim me vendimin 419, datë 25.06.2014, Kreu VI, pika 12, ku shprehet se: “*Procesverbali i dëgjësës mbahet nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga pjesëmarrësit në dëgjësë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut, palëve pjesëmarrëse në dëgjësë, NJVQV-së dhe AKM-së*”, si dhe me VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”

- Në praktikrat e dhënies së mendimit për VNM dhe Lejeve të Tipit B për HEC mungojnë në dosjet përkatëse dokumente plotësuese dhe mbështetëse, që dëshmojnë realizimin e procedurave si: akti i inspektimit apo aktiverifikimit në terren, ose relacioni i përshkrimit të procedurës me emrat e specialisteve që kanë kryer atë, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi e firmosur nga Drejtori DRM.

- Dhënia e mendimit për VNM për leje tipit B, është bërë duke mos u llogaritur e mbajtur parasysh si dhe vlerësuar faktori i prishjes së regjimit natyral të rrjedhjes ujore përgjatë vitit të lumit Osum, si burim i rëndësishëm ujqor. Regjimi i hidrocentralit ndikon mbi florën dhe faunën në rrjedhën e përrenjve, duke ndikuar gjithashtu edhe në vënieën e mbajtjen në funksion të Kanioneve të Osumit, si atraksion kryesor në formën e resursit turistik për zonën e Skraparit.

- **Në shkresat për dhënie mendimi** për VNM në formatin tip të VNM dhe Lejes Mjedisore të tipit A/B të përcjellë nga AKM mungojnë të dhëna për nr. e protokollit, data e shkresës, data e email-it, si dhe të dhënat e autorizimit të AKM, ekzistenca e të cilave do të bënte të mundur evidentimin dhe zbatimin e afateve dhe procedurës së VNM dhe pajisjes së subjekteve me leje tip A, B në kundërshtim. Këto veprime janë në mospërputhje me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje mjedisi të Tipave A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL” shtojcën 4 dhe 5,

- Praktikave të dhënieve të mendimeve për VNM e Leje të Tipit B për HEC nga DRM Berat u **mungon korrespondenca zyrtare në mes AKM Tiranë dhe DRM për informimin e DRM Berat për ecurinë e procedurës**, informacion që do të mundësonte bashkëpunimin ligjor me strukturat e tjera si DRISHMPU, NJQV apo QKL, duke sjellë kështu dhe shkeljen e afateve të miratuara. **Ne 4 raste në vitin 2015 nga AKM** janë kryer licencime e refuzime për leje tipit B, pa u marre mendimi i DRM Berat ( procedurat nr.2,4,5 dhe nr.6 sipas tab.7), në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje mjedisi të Tipave A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL” Kreu II pika 2 dhe Kreu III pika 2 (sipas formatit të shtojcës 4 dhe 5). Rastet sipas viteve paraqiten më poshtë:

### **Viti 2015**

1. DRM Berat me shkresën nr. 98, dt 26.02.2015 “Mendim për VNM” për subjektin HP V E/F.Vendrerish Skrapar, me administrator **J.D.**,për ushtrim të aktivitetit; për ndërtimin e

**hidrocentralit 3. (HEC) Vendresh** ne pellgun ujëmbledhës, **Përroi i Vendreshes**, ndodhur në **Komuna Vendresh** Skrapar fshati Vendresh.

2. DRM Berat me shkresën nr. 127, dt 24.03.2015 “Mendim për VNM” për subjektin **HP B & V Energy/Selia Skrapar-Cerenisht**, me administrator A. F.,për ushtrim të aktivitetit; për ndërtimin e **hidrocentraleve HEC 6. Bigas 1&2**, ndodhur në Pellgu ujëmbledhës, **Përroi i Bigasit** dhe i Veleshnjës Komuna Potom/Çepan Skrapar .

3. DRM Berat me shkresën nr. 148, dt 03.04.2015 “Mendim për VNM” për subjektin **HP-Bigas dhe Veleshnje Energy/Selia Skrapar Cerenisht**, me administrator A. F.,për ushtrim të aktivitetit; për ndërtimin e **HEC Veleshnje ne pellgun ujëmbledhës, përroi Veleshnje** ndodhur në Komuna Potom, Skrapar.

4. **KANIONET**. DRM Berat me shkresën nr. 259, date 24.07.2015 “Mendim për VNM” për subjektin Bashkia Çorovode ,shpk, me administrator E. D. për ushtrim të aktivitetit; **Rikonstruksion dhe ndërtim veprash për zhvillim turistik te Kanioneve te Osunit**, me vendndodhje Bashkia Çorovode Skrapar.

### Viti 2016

1. DRM Berat me shkresën nr. 165, dt 03.05.2016 “Mendim për VNM” për subjektin **HP Z. E./F**, Zaloshje,Skrapar, me administrator J.D. për ushtrim të aktivitetit; Instalim ne pellgun ujëmbledhës, **Përroi i Zaloshnjës** (Ndërtim-operimi-transferimi) për ndërtimin e **hidrocentralit 1. (HEC)** Zaloshje, ndodhur në Komuna Zaloshje Skrapar fshati Vendresh.

2. DRM Berat me shkresën nr. 246, dt 16.06.2016 “Mendim për VNM” për subjektin **HP P 1 & 2 E/Selia Skrapar-Cepan**, me administrator *A.D.i për ushtrim të aktivitetit*; Instalimin për prodhimin e energjisë hidroelektrike për hidrocentralet Prishta 1 dhe Rahovic, ne pellgun ujëmbledhës, **Përroi i Prishtes** për ndërtimin e **hidrocentraleve HEC P & R**, ndodhur në Fshatin Prishtë, Pellgu ujëmbledhës, Përroi i Prishtës dhe /Çepan Skrapar

3. DRM Berat me shkresën nr. 314, dt 29.07.2016 “Mendim për VNM” për subjektin **K. shpk E./Selia Berat Çorovodë**, me administrator D. G. për ushtrim të aktivitetit; Instalimin për prodhimin e energjisë hidroelektrike për **hidrocentralet Malind 1,2,3 nw lumin Malind** ndodhur në **Çorovodë, fshati Malind**.

### Viti 2017

1. **Hidrocentrali me qendër Kreshova/Çorovode**, Ndërtim dhe funksionimi Hidrocentraleve Malind 1,2,3 vendndodhja në afërsi të fshatit Maldin Skrapar Mendim VNM (paraprake) me shkresën nr.36, dt.13.02.2017

2. **Hidrocentrali D. shpk**, me administrator z.I. B, Bashkia Berat, vendndodhja Përroi Dukones, Njesia Administrative Roshnik, Mendimi i dhënë nga DRM është bërë me shkresën nr.130, datë 12.04.2017.

3. **Ndërtim Hidrocentrali Dobrenje** Tomorrice, **DZZ energy, G/Selia Çorovode** me Administratore H. R, vendndodhja Skrapar, fashti Dobrenje Zhope, shfrytëzim **plote i përrenjve** mendimi i dhëne nga DRM date 24.04.2017.

4. **Ndërtim Hidrocentrali Hec-Mivas 1, Subjekti TE** , me Vendndodhje Zhepe Skrapar, aktivitetin e ushtron **ne basen ujore** me Seli Farke Tiranë, nga DRM dhënë mendimi paraprak me datë 25.07.2017.

5. **Ndërtim i Kaskadës së HEC –ve Vokopola 1,2, dhe 3** me përfaqësues ligjor z.C Q,Vendndodhja dhe përroi i Komarit ne territorin e Bashkive Memaliaj , e vendosur **mbi përrua** Tepelene dhe Skrapar, Selia Tirane Mendimi për VNM është dhënë me shkresën nr.286, datë 02.08.2017.

**6. Instalim për prodhimin e Energjisë Hidrologjike Subjekti N. E., me vend-ndodhje**  
Përroi i Nishovës, Bogovë Skrapar, me VNM nr.156, datë 11.05.2017,

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Drejtoria Juridike, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**